

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Vlora Hyseni ju fiku radarët e shtetit!"/ Gazment Bardhi: Ia keni dorëzuar me vetëdije shtetin gupeve kriminale! Agasi solli 12 deputetë...
ADRESA	https://piranjat.al/politike/vlora-hyseni-ju-fiku-radaret-e-shtetit-gazment-bardhi-ia-ke-ni-dorezuar--i105796
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 10:48:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 10:35:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	35368d6907be3b2ffd8a05d9c1547b753253fef80d0a507fd44f3f3fe027a045
TEKSTI	36524c9eef0c1fc4a15c55100998a025b28e85caecf328120acf8f73bcd8f7d9
PAMJA	78b9ff95370067d84cd80853f5600fe96ea2c722bcb4d384c8c933f6219abf7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c5422f4ac4ac2345c89a0f2c0c028dff0b77eae7b3d7c6fc6f45d22d7750297
E MËPARSHMJA	b8b7397d934548a2be70a3ea34d97b7237828cdb8c730b6d3c9def6c85ed1904
RRËNJA MERKLE	d2ca4088eb50e1b4ccc2aac7982103f0051462d31f94452db6e22b0091e548dc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c5422f4ac4ac2345c89a0f2c0c028dff0b77eae7b3d7c6fc6f45d22d7750297>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **dinte, kreu i ri i SHISH të** fundit në institucionet e drejtësisë ■ **agjente serbë!** paprecedentë gazetar... ■ **tjale per ish-shefen e SHISH të** e tij lidhur me akuzat penale dhe ■ **meten one Monika Krvemadhin** shtyrë ditën e sotme. ■ **gjendje të fikti.** Qytetarë...

[POLITIKE](#)

“Vlora Hyseni ju fiku radarët e shtetit!”/ Gazment Bardhi: Ia keni dorëzuar me vetëdije shtetin gupeve kriminale! Agasi solli 12 deputetë...

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 12:35



Kreu i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka hedhur akuza të forta në drejtim të qeverisë gjatë fjalës së tij në Kuvend, duke u ndalur te çështja e drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni.

Bardhi tha se opozita kishte paralajmëruar më herët për emërimin e Hysenit, ndërsa akuzoi mazhorancën se në atë kohë i kishte kundërshtuar pretendimet e opozitës.

“E kuptoj sikletin tuaj që një nga çështjet më të rënda në Shqipëri ta trajtoni duke mbrojtur një të papërgjegjshme, sepse asnjë i përgjegjshëm nuk mund ta marrë fjalën dhe të flasë për 1994, kur sot në 2026 Shqipëri, vend i NATO-s, është provuar”, deklaroi Bardhi.

Ai iu referua gjithashtu pretendimeve të mëparshme të opozitës se Vlora Hyseni ishte emëruar për t'i shërbyer interesave të grupeve kriminale.

“Qeshnit atëherë kur ju thonim që Vlora Hyseni është emërim i Agasit, për t'i shërbyer krimit. Ju qeshnit dhe thonit: Rama zgjedh më të mirët. Ku e keni Edi Ramën sot?”, tha Bardhi.

Më tej, kreu i grupit parlamentar të PD-së ngriti akuza lidhur me pretendimet se Hyseni kishte ndihmuar persona të lidhur me botën e krimit.

“Hyseni jo vetëm ndihmonte kreun e organizatës t'i arratisë drejtësisë, por i thoshte: ‘Thuaju çunave të jenë të qetë, sepse për ty i fik radarët e shtetit’. Dhe vërtetë ia ka fikur radarët shtetit”, u shpreh Bardhi.

Ai e cilësoi situatën si një tregues të asaj që e quajti “narkoshtet”, duke akuzuar qeverinë se ka lejuar grupe kriminale të ndikojnë në funksionimin e institucioneve.

“Nëse kryeministrin e urdhërojnë grupet kriminale, këtu nuk ka më shtet. Ky është antishteti, ku narkosi cakton ministrat, drejtorët e agjencive kryesore në vend, drejtorinë e Kadastrës. Ia keni dorëzuar me vetëdije shtetin grupeve kriminale, sepse dini që janë ato që ju mbajnë në pushtet”, deklaroi Bardhi.

Bardhi përmendi edhe emrin e biznesmenit Ergys Agasi, duke pretenduar se ai ka pasur ndikim në politikë dhe në radhët e Partisë Socialiste.

“A nuk ishte Agasi ai që ka sjellë në sallë 12 deputetë të PS? Me porosi direkte të Ramës, me SMS, ju e dini këtë”, tha ai.

Në përfundim, Bardhi tha se kritikën e tij nuk janë ndaj Partisë Socialiste si forcë politike në tërësi, por ndaj mënyrës se si, sipas tij, është transformuar qeverisja.

“Krimi nuk ka punë me PS-në. PS dhe PD janë asete kombëtare, me të mira e të këqija. Si mund ta shndërrohi në organizatë kriminale? Ka bërë gjëra të këqija, por më parë ka bërë edhe të mira. Çfarë duhet të ndodhë më në këtë vend që Rama të vijë e të japë dorëheqjen?”, përfundoi Bardhi.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 24 Shtator12:30

[Gjekmarkaj, thirrje socialistëve: ‘Reagoni! Ndryshe, nuk jeni më deputetë; Jeni thjesht kartona pa dinjitet’](#)

Deputeti i Partisë Demokratike Agron Gjekmarkaj gjatë fjalës në Kuvend u ka bërë thirrje deputete socialistë që t&eum...

POLITIKE 24 Shtator12:11

[BIRN: Arrestimi i drejtueses së SHISH, goditje e madhe për reputacionin e vendit anëtar të NATO-s](#)

Arrestimi i Vlora Hysenit ka rikthyer vëmendjen te emërimi i saj në vitin 2023 në krye të Shërbimit Informativ të Shtetit t...

POLITIKE 24 Shtator11:49

[Zhupa: Jeni Partia e Skandaleve! Kthyet shtetin në Narko-shtet! Rama të japë dorëheqjen, duhet qeveri tranzitore](#)

Deputetja e PD-së, Ina Zhupa akuzoi kryeministrin Edi Rama se ka vënë në strukturat e shtetit në dispozicion të grupeve të ...

POLITIKE 24 Shtator11:38

[Skandali me SHISH/ Tabaku: U cënua siguria kombëtare, njollë e zezë për Shqipërinë](#)

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, ka reaguar nga Kuvendi lidhur me zhvillimet e fundit, duke kërkuar që deputetët të ndalen dhe t&eum...

POLITIKE 24 Shtator11:20

[Rrëzohet kërkesa e PD për SHISH-in/ Demokratët bllokojnë foltoren, ndërpritet seanca](#)

Mazhoranca ka rrëzuar me forcën e kartonit kërkesën e Partisë Demokratike për ndryshimin e rendit të ditës dhe pë...

POLITIKE 24 Shtator11:04

[Berisha: Bashkëpunimin e Hysenit me Agasin, doni ta shisni si histori rozë, ju shpërthyen “ujërat e zeza”](#)

Kryetari i PD-së, Sali Berisha ka kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama në lidhje me skandalin e AKSHI-t, ku u zbulua dhe përf...

POLITIKE 24 Shtator10:46

[Berisha: Kreu i SHISH, shërbëtorë e Ramës dhe Vuçiçit. Me urdhër ju thërriste ju socialistëve në zyrë, e di vetë ti Damian...](#)

Qytetarët protestojnë para Kuvendit, ndërsa aktualisht mbahet edhe seanca plenare. Kreu i PD Sali Berisha e cilësoi një seancë ...

POLITIKE 24 Shtator10:35

[Skandali i madh në SHISH/ Kalaja: SPAK po publikon vetëm mesazhet erotike, po mundohet të fshehtë të vërtetën](#)

Juristja Adriana Kalaja ka qene e ftuar në emisionin e mëngjesit ‘Kafe Shqetë’ në Syri tv. Ajo në bisedë me moderatorin F...

POLITIKE 24 Shtator10:22

[PD kërkon ndryshimin e rendit të ditës në Kuvend pas masës së SPAK ndaj Vlora Hysenit](#)

Partia Demokratike ka kërkuar ndryshimin e rendit të ditës në Kuvend, pas zhvillimeve të fundit lidhur me arrestimin e ish-drejtoresh...

Nga Genc Pollo POLITIKE 24 Shtator09:49

[Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026](#)

Të thuash se KM Rama duhet të dorëhiqet mbasi është ai që e emëroi Vlora Hysenin shefe të Shërbimit Informativ &e...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

[U vra nga pronari italian i banesës, del autops...](#)

Pak ditë pas vrasjes së 36-vjeçarit shqiptar Gjovalin Lazri nga pronari italian i një banese, mediat italiane japin të tjera detaje p...

AKTUALITET 23 Shtator

"O shpirt, nesër do takoj Kryeministrin"/ Zbard...

Komunikimet e zbuluara mes ish-drejtueses së Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni, dhe Ergys Agasit zbulojnë një tërësi...

AKTUALITET 23 Shtator

"Ergys Agasi filmonte video gjatë takimeve në z...

Gazetarja Anduena Llabani, ndau detaje të tjera në lidhje me hetimet e SPAK-ut në dosjen ku është përfshirë edhe drejtoresha ...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator 11:40

EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...


video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.